



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.12.2019, ora 10:15

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Vijimi i shqyrtimit nen për nen i projektligjit "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"
2. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"
3. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 'Për taksat kombëtare', të ndryshuar"
4. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar"
5. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Edlira Hyseni, Suzana Topi, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Korab Lita dhe Ylli Shehu, Reme Lala, Eljo Hysko.

Mungojnë:

Antoneta Dhima,

Të ftuar:

Ministria e Financave dhe Ekonomise

1. Zv/Minister Z. Elton Haxhi,

2. Z. Niko Lera, Drejtor I Pergjithshem,
3. Z. Enkeleda Pipa, Drejtor I Politikave Fiskale
4. Z. Enkeleda Kuci, Pergjegjes Sektori Politikave
5. Z. Dorian Toro, Specialist

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

1. Znj. Delina Ibrahimaj, Drejtoreshe e Pergjithshme,
2. Znj. Ilda Koja, Drejtor Juridik
3. Z. Klodi Plloca, Drejtr IT

Blerina Gjylameti - ...të aksesohen nga të tjerë, atëherë çfarë do të ndodhë me të dhënat e këtyre kompanive që e kanë transmetuar te kompania, e cila menaxhon, por që nuk ka transmetuar për t'i fiskalizuar tek truri i sistemit? Pra ne cedojmë te një nga hapat.

Pyetja ime është: a do t'ua lëmë përgjegjësinë kompanive të cilat do të fitojnë të drejtën për të qenë pjesë e këtij sistemi dhe më pas t'ua heqim të drejtën institucioneve shtetërore, që kanë përgjegjësinë maksimale për të menaxhuar të gjitha këto të dhëna?

Elton Haxhi – Kjo është një marrëdhënie ndërmjet tatimpaguesit dhe kompanisë që i ofron shërbimin e fiskalizimit. Është e njëjta gjë sikur një kompani të përdorë direkt nga kasa fiskale informacionin që merr për shitje të atij tatimpaguesi. Edhe infrastruktura e serverit të ndërmjetëm është pjesë e konfidencialitetit, që duhet të respektojë kompania, e cila ofron shërbimin e fiskalizimit dhe ne mbajmë përgjegjësi për ruajtjen e konfidencialitetit, që është te platforma qendrore, që ka administrata tatimore. Pra, atë duhet ta respektojnë kompanitë dhe është marrëveshje mes tyre.

Blerina Gjylameti – Ne kemi një sistem të ndërmjetëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ligjin po e bëjmë ne, e kemi ne, nuk e ka biznesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Zoti Zëvendësministër, me qetësi!

Janë 110 mijë tatimpagues në biznesin e vogël që mund të zgjedhin alternativën e kasës, këtë të drejtë kanë dhe ne do t'ia lëmë me ligj. Ata e duan, sepse ligji ua jep si alternativë, që do të thotë se administrata, e cila ofron fiskalizimin është përgjegjëse, se ne nuk i detyrojmë tatimpaguesit të blejnë kasat apo *softe*-t, apo certifikatën dhe firmën elektronike, por ne u themi që mund ta blejnë serverin e ndërmjetëm pa detyrim. Ata nuk janë përgjegjës edhe për administrimin, prandaj merre me qetësi, se ajo që po të thotë zonja Gjylameti është që sistemi

të jetë integral dhe i sigurt. Unë kam punuar me ty dhe kam shumë respekt për profesionalizmin tënd, si dhe për orët e punës që ti vë në atë ministri, e vlerësoj shumë këtë, por ata nuk do të flasin për tatimpaguesit dhe kompanitë, se janë pjesë e terrenit tonë ekonomik dhe do të duhet ta mendoni, sepse në një moment, kur të ketë problem, përgjegjëse është Ministria e Financave dhe jo tatimpaguesi, përgjegjës është autoriteti fiskal, je ti, si institucion. Do të të duhet ta mendosh tani këtë zgjidhje, në mënyrë që nesër të mos e kesh këtë problem. Ky është i gjithë shqetësimi i deputetëve, se mund të themi e kanë ata, apo këta, por kur të përplasen me terrenin ekonomik mund të krijojnë problematika. Po të ishte ndryshe ne nuk do të ishim kaq të vëmendshëm fjalë për fjalë, se kemi merakun që të mos krijohet asnjë përplasje në terrenin ekonomik.

Elton Haxhi – Ajo që ne kemi përcaktuar në projektligj nuk e përjashton zgjidhjen e serverit të ndërmjetëm. Kjo do të thotë që jo vetëm 4 kompanitë e kasave mund të kenë një server të ndërmjetëm, por edhe një supermarket i madh mund të bëjë një zgjidhje të ngjashme, pra mund të ngrejë një server të ndërmjetëm dhe të ketë të gjithë *network*-un e vet, të kalojë përmes serverit të ndërmjetëm që do të ngrejë supermarketi. Kjo që ju propozoni është që Administrata Tatimore të jetë përgjegjëse për të gjithë serverat e ndërmjetëm që mund t'i shkrepën dikujt në kokë, për ta dhënë si zgjidhje alternative fiskalizimin. Nëse do ta hapim administrimin që për këtë server të ndërmjetëm, i bie që nesër mund të dalë një server tjetër, pasnesër një tjetër, kështu që është e pamundur të administrohen serverat e ndërmjetëm, të cilat janë përgjegjësi e zgjidhjes nga kompanitë, të cilat ofrojnë shërbimin e fiskalizimit.

Arben Ahmetaj – Një sekondë ta ndjekim me kujdes ministrinë! Mirë, kemi një argument këtu, që duhet ta diskutojmë. Çfarë mund të bëni ju praktikisht? Po liberalizoni ndërfaqësimin, po e quaj. Ne kërkuam që të kishte një ndërfaqe përveç sistemit të fiskalizimit *software*, pra të kishte një server të menaxhuar nga ju dhe të financuar nga kompanitë e kasave, të gjitha të kishin një grykë. Nëse kjo nuk është zgjidhje, atëherë do të duam që në një moment të na sqaroni teknikisht se si sigurohet informacioni, se ky është merak.

Pra kemi një argument: nëse ju e liberalizoni, Drejtoria e Tatimeve nuk mund të jetë përgjegjëse për menaxhimin, por për sigurinë që nga *server*-i deri të truri. Kësaj çështjeje do t'i kthehemi pa kamera, sepse shqetësimi i deputetëve është legjitim, pasi ka të bëjë me sigurinë e të dhënave dhe me zhbërjen.

Po, Senida.

Senida Mesi – Meqë jemi te ky diskutim, le të mbetemi këtu. Unë do të doja një shpjegim të arkitekturës në detaje me rolet dhe përgjegjësitë. Çfarë roli dhe përgjegjësie ka tatimpaguesi, Drejtoria e Tatimeve apo institucionet e fiskut, kompanitë e fiskut 1, 2 apo 18?

Sot po miratojmë një ligj ku nuk e kemi të qartë se si do të menaxhohet pjesa e *software-it*. Nëse nuk e kam të qartë unë, që do ta aprovoj një projektligj të tillë, a e keni ju si të paktën si Drejtori e Tatimeve dhe IT-së se si do të jetë kjo arkitekturë? Në këto detaje, që unë kërkoj, a e kanë të qartë kompanitë, të cilat do të ofrojnë nesër shërbimin, se çfarë do të ofrojnë dhe çfarë do të kontrollojnë aty? Në të gjithë këtë diskutim, marrëdhënia e tatimpaguesve me Drejtorinë e Tatimeve është juaja dhe ne bashkë me ju duhet ta mbrojmë këtë marrëdhënie. Të tjerat që janë *third party*, palët e treta, që ofrojnë një shërbim, të liberalizuar apo jo, duhet të luajnë në bazë të rregullave të lojës të përcaktuara mbi bazë ligjore, për të garantuar sigurinë me tatimpaguesit.

Kush do t'i mbrojë ata nesër? 120 mijë tatimpaguesit duhet të jenë të garantuar nga ne sot këtu dhe nga ju nesër, që ky ligj garanton jo vetëm informacionin, jo vetëm të dhënat sensible, por edhe i garanton ata në çdo marrëdhënie që hyjnë me palët e treta, përndryshe do të kenë problem, do të keni edhe ju, dhe ligji do të kthehet këtu prapë.

I nderuar, zoti kryetar, ne dje caktuam një afat që fillonte me pagesat *cash* në gusht të vitit që vjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, sepse me të gjitha këto probleme teknike e shoh që kërkohet edhe një *trial period*, pra një periudhë ku ti e teston, e sheh që funksionon gjithçka mirë, për ta zgjeruar më tutje në tatimpaguesit e tjerë.

Arben Ahmetaj – Senida, jeni shumë e saktë, ky ka qenë dhe shqetësimi i shumë deputetëve kur kemi diskutuar teknikisht, por edhe imi. Shtyrja e afatit kërkohet më shumë për testimin e sistemeve dhe qëndrimi im ka qenë që fillimisht të jetë biznes me biznes dhe biznes me qeveri. Këto kohë kam pasur fatin të vizitoj qendrën e informacionit të Italisë, pra një qendër të ngjashme, kam qenë edhe me Nikon në 1998-n, kam qenë edhe para 2 muajsh, e cila ishte bunkerike, në sensin e sigurisë dhe ata, që janë shumë më përpara se ne në teknologji, e kishin bërë gradualisht për të certifikuar edhe sistemet, se sistemet e reja duan kohën e tyre, por edhe tatimpaguesit kanë nevojë për kohën e tyre për t'u përshtatur me ndryshimet. Prandaj ne kemi kërkuar një shtyrje për një periudhë pak më të gjatë, pra deri në shtator dhe deri në janar të vitit 2021 pas një vlerësimi që do të bëhet në Komisionin e Ekonomisë.

Senida Mesi – Jemi dakord të gjithë për periudhën e testimi, pra jo që ne direkt e zbatojmë, pra heqim sistemet e vjetra, zbatojmë të riun dhe pastaj ndodh çfarë ndodh.

Arben Ahmetaj – Fjala që keni përdorur në ligj “ata” të zëvendësohet me fjalën “blerësi”, me kusht që të na sillni një ditë këtu shkruarit e ligjit pa kamera.

Në pikën 10 sugjeroj të riformulohet për teknikë legislative. Gjithashtu sugjeroj shtimin e mundësisë së fiskalizimit dhe, për rrjedhojë, edhe të njohjes së rasteve të rishikimit të deklaratës doganore nga autoritetet doganore, si pasojë e vlerësimit doganor ose kontrollit pas zhdoganimit brenda afatit të përcaktuar në Kodin Doganor. Për këto raste do të sugjeroja që fiskalizimi të bëhet pas korrigjimit të të dhënave të faturës bazë në deklaratën doganore të rivlerësuar apo të rishikuar, se ju e dini shumë mirë që do të prekte llogaritjen e TVSH-në. Sugjeroj të hiqet nga pika 10 dhe të bashkohet e riparë në pikën 11, që të kemi në një pikë të vetme aktet nënligjore dhe të riformulohet me këtë përmbajtje:

“Procedura e fiskalizimit të faturës për importin e mallrave, në rastet e parashikuara në pikën 7 të këtij neni, kryhet nga marrësi i mallrave në Republikën e Shqipërisë, bazuar në deklaratën doganore, pas vendosjes së mallrave nën regjimin e hedhjes për qarkullim të lirë, por jo më vonë se 3 ditë nga vendosja e mallrave në këtë regjim. Në rast të rishikimit të deklaratës doganore, si pasojë e rivlerësimit doganor, ose kontrollit pas zhdoganimit, brenda afatit të përcaktuar në Kodin Doganor, blerësi që ka kryer procesin e fiskalizimit bën menjëherë korrigjimin e të dhënave të faturës bazuar në deklaratën doganore të rishikuar dhe e dërgon atë pranë Administratës Tatimore. Në rastin e furnizimit nga jashtë të shërbimeve, blerësi vendas i shërbimit, që ka marrë një faturë elektronike nga jashtë shtetit, kryen procesin e fiskalizimit brenda afatit të referuar në pikën 3 të nenit 8 të këtij ligji”.

Pika 11. Sugjeroj riformulimin për teknikë legislative duke u bashkuar në fjalinë e fundit të pikës 10, siç thashë më lart.

Niko, më ndiq, mos fol me zëvendësministrin, se do të mbash qëndrim”.

“Për qëllime të zbatimit të këtij neni, ministri përgjegjës për Financat përcakton me udhëzim detyrimet e tatimpaguesit në procesin e fiskalizimit të faturës, procedurën dhe mekanizmat për zbatimin e saj dhe të dhënat shtesë të kërkuara sipas këtij ligji”.

A ka kush ndonjë opinion për nenin 20? Nuk ka.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21 i projektligjit.

Lidhur me formulimin e pikës 3 nuk kuptohet se si një blerës, kur është përballë një automati, mund të kërkojë faturë të printuar, pra nuk kuptohet se si do të zbatohet pjesa e dytë e kësaj pike. Cila është pjesa e dytë e kësaj pike?

Zoti Niko, Enkeljda nuk është personi i duhur për t’u konsultuar në këtë moment.

Pika 3. Pavarësisht nga pika 4 e nenit 6 e këtij ligji, dërgimi i të dhënave mbi shitjet në Administratën Tatimore Qendrore në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni, konsiderohet që

të ketë përmbushur detyrimin e lëshimit të faturës. Sipas këtij ligji kjo faturë nuk ka nevojë të printohet dhe t'i dorëzohet blerësit, përveç nëse kërkohet për tatimpagues të cilët operojnë në sektorë të veçantë të ekonomisë, në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për Financat. Në këtë rast printohet një faturë e thjesht sipas nenit 11 të këtij ligji”.

Për shembull, unë jam përballë automatit, se teknologjia ecën, çfarë ndodh?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të ketë ndonjë buton?

Po nëse nuk do të jetë as njëra e as tjetra, çfarë duhet të bëjë unë si tatimpagues?

Elton Haxhi – Automatet, në fund fare, pasi mbaron veprimet, kanë opsionin që të ofrojnë faturën. E njëjta gjë do të jetë edhe me automatet që shesin produkte.

Arben Ahmetaj – Kur ka rënë një pallat diku, ka rënë për një detaj të markës së betonit, ose të spesorit të hekurit, kështu që ka një shprehje të vjetër për të tilla raste “Detajet përbëjnë jetën, jo diferencën”.

Për të mos ndërhyrë në nen, unë do t’ju lutesha, të nxirrni një urdhër kur të fillojë fiskalizimi të rakordohet zyrtarisht që të gjithë pronarët e kompanive që kanë automatet, ta kofigurojnë me pyetjen “A doni faturë?” dhe nëse përgjigjen po, atëherë të printohet fatura dhe fatura të jetë formati që kërkohet nga sistemi i fiskalizimit, që do të thotë të rikonfigurohen të gjitha automatet.

Senida Mesi – Automatet aktuale, me çfarë kam parë dhe me njohuritë që kam, janë komplet mekanike, kanë vetëm një kontakt me energjinë elektrike. Ne do të kërkojmë që ato të dalin jashtë përdorimit dhe të blihen...

Arben Ahmetaj – Nga ajo që tha zëvendësministri mund të adoptohen me *voice recognition*. Gjithsesi kjo pikë duhet parë me shërbimet, se mund të krijojmë shqetësime në terrenin ekonomik.

Faleminderit komisionit për vëmendjen ndaj detajeve, se çdo detaj i korrigjuar pozitivisht këtu, ndihmon terrenin ekonomik dhe tatimpaguesit.

Vazhdojmë me votimin për 21-in me këtë korrigjim!

A jeni dakord Zëvendësministër, që ta shihni me shërbimet e Kuvendit?

Faleminderit!

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22.

Në këtë dispozitë nuk kuptohet se cila është kategoria e tatimpaguesve që lëshojnë faturë me para në dorë, që synon të trajtojë te procedura e thjeshtëzuar e fiskalizimit. Nenet 18

dhe 20 kanë përcaktuar procesin e fiskalizimit për tatimpaguesit. Pika 1 e nenit 22 fillon me përcaktimin “Me përjashtim të neneve 16, 18 dhe 20 të këtij ligji” nene që, në fakt, i përshijnë të gjithë tatimpaguesit. Kjo pikë ka nevojë për shpjegime nga propozuesi.

Fjala për ju.

Keni kohën 2 minuta të konsultohuni me shkruesit shkruesve, që keni mbrapa.

Elton Haxhi – Është menduar që për një kategori biznesesh, që do të përcaktohen me VKM, platforma qendrore do të ofrojë një *self carë portal*, që do t’u ofrojë këtyre tatimpaguesve fiskalizimin nëpërmjet platformës qendrore. Pra, nuk do të ketë nevojë për instalim pajisjesh softuerike apo pajisjesh harduere, kasa fiskale, por do të kenë akses direkt te kjo platformë qendrore dhe do të fiskalizojnë aty faturat e tyre.

Nga analiza që kemi bërë ne, kuptojmë se bëhet fjalë për ata tatimpagues që janë deri në fashën e 2-milionëshit, pra janë të përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe që kanë një numër shumë të kufizuar transaksionesh. Ne e kemi bërë publike VKM-në, pra është në konsultim publik kjo VKM që ka lidhje me këtë procedurë të thjeshtuar dhe kemi menduar që limiti i transaksioneve të jetë jo më shumë se një faturë në ditë (350 fatura në vit e kemi përcaktuar ne). Pra, të gjitha bizneset deri në 2 milionë xhiro, që s’janë subjekte të TVSH-së, me transaksione vjetore deri në 350 në vit mund të kenë akses në këtë platformë dhe t’i fiskalizojnë aty faturat pa asnjë kosto.

Arben Ahmetaj – Pra, ju po propozoni që nga 0-2 milionë të jenë të fiskalizuar dhe të përdorin këtë sistem në formën e thjeshtëzuar.

Këtë gjë unë dua ta hap për diskutim në komision.

Unë mendoj që bizneset 0-2 milionë të mos jenë të përfshirë në fiskalizim, të mos kenë detyrim. Kryeministri, kur hodhi iniciativën, ka pasur idenë që të lihen jashtë. Këta nuk presupozohen tatimpagues tipikë, le të themi, të sipërmarrjes. Këto janë gati-gati të vetëpunësuar.

E para dhe mbi të gjitha, nën 8 milionë shtyhet për në 1 janar 2021, pas vlerësimit që do të bëhet në këtë komision.

E dyta, nuk është qershori, por është shtatori.

Urdhëroni!

Senida Mesi – Komenti i parë vjen si rrjedhojë e definimit të nenit 22, pika 1, ku përmenden 4 nene dhe përcaktim me VKM.

Nëse ju e keni propozimin e qartë, e dini se për kë bëhet fjalë si kategori, propozimi im konkret është që të përfshihet si nen në këtë ligj dhe jo me VKM.

E dyta, jam dakord me çfarë tha kryetari, që ne si anëtarë të komisionit, unë personalisht, nuk jam dakord që ne të fillojmë në këtë fazë që jemi me 90 e ca për qind të subjekteve në Republikën e Shqipërisë, për të implementuar këtë ligj, por të fillojmë me bizneset e mëdha, të fillojmë me 5%-shin, me 2%-shin e bizneseve, të cilët kanë edhe infrastrukturën, kanë edhe njohurinë, kanë edhe buxhetet, edhe financimin, kanë edhe *know-how*, kanë edhe ekspertizën financiare për të implementuar një gjë të tillë dhe vetëm pasi ne të jemi të bindur, ju të parët, që kjo funksionin dhe është kuptuar dhe mirëkuptuar, të përfshijmë pastaj edhe gjithë bazën.

Unë e lexoj ligjin dhe, sinqerisht, u kërkova edhe shërbimeve të komisionit për të definuar vetëm në nene, pra sa nene të këtij ligji përcaktojnë udhëzim të ministrit përgjegjës për financat dhe sa nene kërkojnë VKM, si rrjedhojë e implementimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit.

Pra, mbi vështirësinë dhe teknikalitetin e këtij ligji, do të lexojmë dhe do të jemi nën supervizim apo në monitorim, doli apo nuk doli udhëzimi. Tani po flas me gjuhën e një sipërmarrësi të vogël, i cili dëshiron të hapë një biznes dhe nuk ka as lekë, as buxhet të mjaftueshëm për të paguar një ekspert, që di ta përkthejë një gjë të tillë, por vret mendjen si të hapë një biznes, si të punësoj dy familjarë apo dy miq, si të bëjë ndonjë lekë dhe si në fund të muajit të nxjerrë një fitim për veten e tij.

Pra, nuk dua në asnjë mënyrë që ky ligj të vrasë shpirtin e sipërmarrjes.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Zoti zëvendësministër, më korrigjoni nëse nuk jemi në një gjatësi vale! Ju nuk është se po përjashtoni me VKM, ju po ofroni një instrument alternativ me VKM. Po theksojeni, ju lutem, se duket si përjashtim me VKM!

E dyta, unë propozoj që këta të jenë të përjashtuar, këta të vazhdojnë me rutinën e zakonshme sot.

(Diskutime pa mikrofon)

Sqaroheni në nen që nuk është përjashtim! Jepni një alternativë me VKM për të përdorur një instrument të thjeshtësuar! Pra, një alternativë lokimi e thjeshtëzuar për biznesin nga zero deri në 2 milionë dhe mos ua kufizoni numrin e faturave nga një në ditë.

(Diskutime pa mikrofon)

Jepi të drejtën që të ketë alternativën e thjeshtëzuar, por mos ia kufizo me numër faturash!

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, të biem dakord me logjikën e komisionit!

Faleminderit!

Neni 22, me këto ndryshme që thamë?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 23.

Pika 1, sugjeroj të riformulohet për teknikë legjislativë dhe saktësim si më poshtë:

“Fatura për pagesat me para në dorë do të printohet në letër, të përmbajë të gjithë të dhënat sipas përcaktimeve të këtij ligj dhe legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar, i nënshtrohet procedurës së fiskalizimit, sipas këtij ligji dhe i dorëzohet blerësit në momentin e furnizimit të mallrave ose shërbimeve”.

A ka ndonjë koment për këtë nen?

Urdhëroni!

Senida Mesi – Është semantikë, por e kishim edhe te pika 2 e nenit 22 dhe e gjej përsëri te pika 1 e nenit 23 shprehjen “të printohet në letër”.

Pyetja ime është: Ku mund të printojmë tjetër?

Arben Ahmetaj – Po shkenca ecën, Senida. Nuk bën dëm në administrim.

(Diskutime pa mikrofon)

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 24.

Këtu nuk kemi asnjë ndryshim dhe asnjë koment.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 25.

Komision i Integritetit ka sugjeruar që në pikën 2, fjala “i ekzekutimit” të zëvendësohet me fjalën “i përmbushjes”.

A keni ndonjë problem ju si Ministri Financash? Jo. Atëherë, merret parasysh ky sugjerim.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 26.

Në pikën 2 sugjeroj që fjala “caktohet” të zëvendësohet me fjalën “regjistrohet”.

A ka komente të tjera për nenin 26? Nuk ka.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 27.

Pika 1 sugjerohet të riformulohet si vijon: “Tatimpaguesit në rastet e lëshimit ose pranimit të faturave elektronike sipas përcaktimeve të nenit 24, 25 të këtij ligji mund të përpilojnë, fiskalizojnë dhe dërgojnë këto fatura elektronike te blerësi ose t’i pranojnë faturat elektronike nëpërmjet platformës qendrore të faturave. Kategoria e tatimpaguesve dhe kriteret e nevojshme për qëllimet e zbatimit të kësaj pike përcaktohen me VKM.”

Jeni dakord me këtë formulim? Dakord.

A ka komente të tjera për nenin 27? Nuk ka.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 28.

Në pikën 1 mendoj se nuk mund të specifikohet në ligj numri i një standardi, pasi standardet ndryshojnë në periodicitet e për rrjedhojë duhet të ndryshuar edhe ligji. Për këtë arsye, për saktësim të pikës 1 dhe për teknikë legjislative sugjeroj riformulimin me përmbajtjen e mëposhtme:

“1. Faturat elektronike të lëshuara sipas këtij ligji duhet të jenë në përputhje me këtë ligj dhe specifikimet teknike të përcaktuara në standardet shqiptare apo dokumente të tjera të barasvlershme me to”.

Ka edhe amendim të propozuar nga Komisioni i Integritetit në lidhje me pikën 3 të këtij neni, në fillim të pikës 3.

Pika “besueshmëria” të zëvendësohet me fjalën “vërtetësia”.

A ka komente të tjera për nenin 28? Nuk ka.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 29.

Pika 1, për qëllimet e teknikës legjislative dhe saktësim, sugjeroj të riformulohet në këtë përmbajtje:

“1. Përgjashtimisht përcaktimeve të nenit 18, 20, 21 të këtij ligji, në rast të ndërprerjes së lidhjes elektronike, internetit, tatimpaguesi lëshon faturën, e cila përmban të dhënat e përcaktuara në kreun 4 të këtij ligji, më përjashtim të NIVFN-së që është elektronike dhe e printon faturën në letër”.

Senida Mesi – Dua thjesht të kontrolloj nëse ka përputhje midis nenit 29 dhe nenit 21, sepse neni 21, pika 1, thotë që duhet t’ia dërgojë informacionet administratës tatimore qendrore

nëpërmjet lidhjes me internet, para se t'i lëshojë blerësit faturën. Kurse këtu transaksioni me blerësin bëhet apo nuk bëhet? Blerësi në atë moment e merr?

Arben Ahmetaj – Transaksioni do të bëhet. Fatura do të jetë përjashtimisht e një forme tjetër për shkak se ai nuk përdor dot sistemin e fiskalizimit se nuk ka internet, nuk do të ketë vetëm NIVFN-në, që është kodifikimi në sistemin e fiskalizimit.

Jemi dakord? Dakord.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 30.

Në pikën 1 sugjerohet heqja e referencës te përkufizimet.

Në pikën 3 fjalët “pas ditës” të zëvendësohen me fjalët “nga e nesërmeja e ditës”, që të përcaktohet saktë. Kjo është për teknikë legjislative dhe unifikim të mënyrës së përlogaritjes së afateve sipas kodit të procedurës administrative.

Urdhëroni!

Vullnet Sinaj – Te pika 4 e këtij neni thuhet: “brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, tatimpaguesi që lëshon faturë detyrohet t'i fusë të gjitha faturat në sistemin fiskal dhe t'i paraqesë ato në administratën tatimore qendrore nëpërmjet lidhjes elektronike, internetit, nëpërmjet një protokolli të veçantë në përputhje me udhëzimet...”. Pra, pika 4 i referohet pikës 3 në rastet kur prishet pajisja elektronike.

Në pikën 3 thuhet që në rastin e referuar në pikën 1 të këtij neni, tatimpaguesi që lëshon faturë, detyrohet që brenda 5 ditëve, pas ditës kur pajisja fiskale ka ndaluar plotësisht së funksionuari, të mundësojë funksionimin e pajisjes për lëshimin e faturave fiskale ose të sigurojë një pajisje të re.

Kur kalojmë në pikën 4, ku thuhet se brenda këtij afati duhet të hidhen të gjitha faturat, kjo është e pamundur.

Duhet të rregullohet pika 4 dhe të thuhet “5 ditë pas vendosjes së pajisjes fiskale në gjendje pune”.

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, pika 4 e nenit 30 i referohet pikës 3 që ka të bëjë me rastin kur prishen pajisjet elektronike dhe ato duhet të vendosen në punë brenda pesë ditëve, ose të zëvendësohen me pajisje të reja. Ndërsa pika 4 thotë: “Brenda këtij afati duhet të jenë hedhur edhe të gjitha faturat që kanë ngelur pa hedhur kur pajisja elektronike ka qenë e dëmtuar.”

Kjo është e pamundur të bëhet. Pra, duhet që, pesë ditë pasi të jetë rregulluar pajisja elektronike.

Arben Ahmetaj – T’i bëj një pyetje administratës: a keni ndonjë problem me kohën?
Sepse thelbi i fjalës tënde është te koha, apo jo, Vullnet?

Vullnet Sinaj – Jo, unë u sqarova me ta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Është në rregull?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bën sens.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund ta marrësh mikrofonin, zoti Niko?

Niko Lera – Te pika 3 mund të themi: pesë ditë pas afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, tatimpaguesi që lëshon faturë e të tjerë e të tjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, te katra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pesë ditë pas afatit të përcaktuar në pikën 3. Pra, ishin pesë ditë? Le shtojmë edhe pesë ditë të tjera.

Arben Ahmetaj – Qartë pra, qartë!

Atëherë, me ndryshimin që propozoi Vullneti, bashkë me komentet që kam bërë unë, kalon neni 30.

Kush është pro propozimit të Vullnetit dhe sugjerimeve të bëra nga unë për teknikë legjislativë?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Ministria e Financave, bashkë me Shërbimet e Kuvendit, le të reflektojnë ndryshimin që bëri zoti Vullnet Sinaj, si dhe teknikën legjislativë që sugjerova unë.

Neni 31, në pikën 3, shkronja ‘a’, përcaktimi drejtpërdrejt në person, sugjeroj të zëvendësohet me “post ose personalisht”, ose “drejtpërdrejt në person”.

Mund të më thoni nju se çfarë kuptimi ka? Aman!

“Me post ose personalisht”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Me post ose personalisht”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po mirë pra, thoni se jeni dakord, se na ënjtët!

Kush është pro këtij sugjerimi? Kundër? Abstenim?

Miratohet edhe neni 31!

Neni 32 nuk ka komente.

Faleminderit shkruesve që kanë qenë korrekt si rrallëherë në ligj.

Kush është pro neni 32? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 33. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 34. Në pikën 2 sugjeroj heqjen e fjalëve: “sipas pikës 1 të këtij neni”, si të panevojshme. Kreu 10, i përbërë nga nenet 37...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë po ngelemi te neni 34. Në rregull!

Kush është pro heqjes së fjalëve te neni 34?

Përtoni të ngrini edhe dorën, ë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është ligj i rëndësishëm.

Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet si nen, me 100 % të votave të komisionit.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qartë!

Neni 35. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 36. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet edhe ky nen me 100% të votave!

Kalojmë te kreu 10, që përbëhet nga nenet 37, 38 i projektligjit, trajton rregullimin e pagesave me para në dorë, duke e detyruar tatimpaguesin për depozitim në bankë të parave të grumbulluara gjatë ditës përtej limitit të lejuar të arkës, si dhe të përcaktojë limitin e arkës. Në frymën e diskutimeve e të propozimeve të komisionit, vlerësohet se kreu i 10-të të hiqet, si i panevojshëm për qëllimet e këtij ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Një gjë është e sigurtë: që ne duhet të shkojmë drejt kufizimit të veprimeve me para në dorë. Kjo nuk ka diskutim, siç nuk ka diskutim që kjo mënyrë duhet zëvendësuar me një mënyrë tjetër, qoftë nëpërmjet llogarive bankare, qoftë nëpërmjet kartave

të kreditit, karta krediti të biznesit. Edhe bizneset ku drejtohesh për të marrë furnizime të shpejta, të vogla, të nevojshme, që dikur paguaje me para në dorë, se po e konsideroj “dikur” pagesën me para në dorë, duhet të kenë aparatet përkatëse, që në Shqipëri nuk janë, por që duhet të jenë pjesë e këtij projekti ose jo, gjë që unë nuk e di.

Pra, ju me të vërtetë dëshironi që ata të shkojnë e të blejnë me kartë, sepse kanë nevojë të shkojnë e të blejnë shpejt me kartë, por ai atje nuk ka makinë për kartat.

Kemi që nga vitit 1998, pra 21 vjet, që kemi iniciuar futjen e kartave të kreditit; që kemi iniciuar mundësisht kufizimin e parasë kesh; që i kemi detyruar qytetarët, punonjësit, administratën, për t'i futur të gjitha pagat në llogari bankare, e që të nesërmen e tërheqin keshin komplet, 90 %, me ato karta krediti.

Kjo do të thotë se diçka nuk ka funksionuar. Pra, kjo logjikë, jo ky nen, jo ky kapitull, është një logjikë shumë e mirë, një logjikë normale, e cila kërkon një mënyrë të vepruari për të arritur te kjo. Për mendimin tim, është e parakohshme, në rrethanat që keni ju.

Zgjidhjet janë dy. Cilat janë ato? Zgjidhja e parë është të rrëzohet ky kapitull me dy nene, dhe të kalojë te një ligj tjetër, sepse, të themi të vërtetën, këtu s'është shumë i lidhur. Është i lidhur për shkak të dorëzimit të faturave dhe të parasë së mbledhur, kur flasim për dyqanet, kur flasim për supermarkete, por është e kundërta për ata që duan të venë të blejnë, jo për ata që presin blerësit.

Zgjidhja e parë është të rrëzohet këtu, dhe duke riparë sasinë ose masën e limitit që do t'i lëmë në arkë. Për shembull, ju thoni 55 mijë lekë për një xhiro deri 2 milionë. Pse jo 60, për shembull? Ku e gjetët 55-ën? Nga se u nisët? Çfarë kriteresh keni pasur? Duhet të na thoni disa shpjegime, se mbi ç'bazë i keni vendosur këto? Pra, duhet riparë edhe kjo. Kjo është zgjidhja e parë.

Zgjidhja e dytë. Në qoftë se ju jeni të ndërgjegjshëm, jo për kapriço e as për dëshirën, se po përdor këtë fjalinë e Benit, e shkruesve të shkruesve, as si pjesë e ndonjë skeme apo projekti, por në qoftë se s'jeni gati, mos na bini në qafë të bëni një gjë të tillë. Flas në emër të të gjithëve.

E vëmë te ligji i kontabilitetit apo te një ligj tjetër, duke e parë më me kujdes dhe duke qenë të gatshëm.

Kjo është thirrja ime. Pra, ka dy zgjidhje: ose rishikojmë kufijtë këtu, dhe ju na garantoni që jeni të sigurtë se kjo do të funksionojë, ndonëse për mua nuk funksionon, nuk funksionon në këtë moment, se e thashë që në fillim se jam dakord me strategjinë për të kufizuar përdorimin e keshit, ose, nëse ju na garantoni, t'i hedhim një sy këtyre këtu, të bindemi dhe le ta rregullojmë.

Ky është mendimi im.

Arben Ahmetaj – Më fal, a mund të ndaj me ju një problem logjistik të kohës? Unë tani kam një takim. Ndoshta duhet ta marrë njëri nga ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, unë kam propozim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, s'kemi dhe një nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse, e hoqëm këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Si mendoni, zoti zëvendësministër, në lidhje me propozimin e zotit Angjeli?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Kushi, edhe ju?

Evis Kushi – Po.

Arben Ahmetaj – Më falni, ka edhe zonja Kushi diçka, zoti zëvendësministër. Mund ta merrni fjalën pastaj, që t'i mblidhni pyetjet.

Evis Kushi – Në fakt, në lidhje me këtë nen ka shqetësime edhe nga biznesi, sepse ata mendojnë se vendimi për të mbajtur para përtej limitit të kasës kesh apo për t'i dorëzuar në bankë, duhet të jetë vendim që i takon atyre. Kjo sepse keshi është pasuri e biznesit. Për shembull, ata mendojnë se, për të shmangur rrezikun e krizave bankare apo falimentit, ata duhet të kenë një rezervë monetare, dhe e dinë ata nëse duhet ta dorëzojnë në bankë apo duhet ta mbajnë kesh një sasi të caktuar. Sepse, këtu është që përtej një limitit, gjithçka duhet të depozitohet në bankë. Me anë të këtij ligji, rreziku transferohet i gjithi te bizneset.

Ky është shqetësimi që kanë ata. Megjithatë, ne mund ta diskutojmë dhe të vendosim se cila është më e mira, por ama ata e kanë sjellë si shqetësim.

Arben Ahmetaj – Po, ju lutem, zoti zëvendësministër.

Elton Haxhi – Iniciativa ligjore, përveç synimit që prezantoi deputeti, ka edhe aspektin e kontrollit tatimor. Ajo është kryesorja, reduktimi i keshit në ekonomi, i cili është një synim që duam ta arrijmë. Tjetra është ulja e informalitetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, por raportimin në kohë reale dhe kontrollin e gjendjes së keshit nuk e kam, nëse e fusim në këtë ligj Mund ta realizoj vetëm nëpërmjet këtij sistemi. Infrastruktura IT mund të më

sigurojë një monitorim në distancë. Prandaj është vënë këtu. Nuk e gjejmë të përshtatshme dhe nuk mund të ketë të njëjtin efektivitet në një ligj tjetër. Këtu më jep edhe mundësinë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, te pjesa e nivelit, pra te limiti që diskutuam...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një iniciativë e tillë ligjore mund të çojë në një reagim të biznesit për të marrë pajisjet që lexojnë kartat e kreditit dhe debitit. Pra, duhet ndërmarrë një iniciativë, që është shkak-pasojë. Bëjmë një iniciativë këtu, që të detyrojmë biznesin. Detyrimin nuk e kemi kaq të ngurtë, sepse, kur kemi vendosur limitet, logjika ka qenë respektimi i një afati dhjetëditor. Pra, nëse e shohim, deri në 2 milionë për bizneset e kemi vendosur limitin 55 mijë lekë, që përkthehet në dhjetë ditë xhiro. Pra, nëse merr 2-milionëshin për 365 ditë, i bie që dhjetë ditë ai mund të shesë kesh, të arkëtojë, ndërsa në fund të dhjetë ditëve do të jetë i detyruar të shkojë e t'i depozitojë në bankë.

Pra, mendoj se është një afat i arsyeshëm. Për nivelin e keshit mund të diskutojmë nëse duhet ngritur akoma më tej, por gjithsesi mendoj se dhjetë ditë janë mjaftueshëm për t'i dhënë fleksibilitet biznesit, që edhe të arkëtojë, edhe të ketë akses në bankë.

Arben Ahmetaj – Po, Vullnet.

Vullnet Sinaj – Kam një propozim direkt në lidhje me nenin 37. Në fund fare, te pika 1, që detyrohen të derdhin lekët ditën e ardhshme të punës. Por dita e ardhshme e punës së biznesit mund të qëllojë ditë pushimi. Mbase duhet shtuar një paragraf aty, që nëse dita e ardhshme e punës është ditë pushimi, atëherë ditën e parë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të bëjmë një shtesë.

Shiko tani, se bizneset punojnë edhe ditëve të pushimit. Dita e ardhshme e punës së tij mund të qëllojë ditë pushimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e sqaruar kjo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull!

Ndërsa në lidhje me pjesën e vlerës së keshit, që ju keni menduar të mbahet, unë them se kjo vlerë që ju keni menduar është e arsyeshme. Madje, mendoj se kjo edhe do ta ndihmojë biznesin nga ndonjë vjedhje apo grabitje që mund të ndodhë, të cilat kanë ndodhur shpesh nëpër biznese. Nuk kanë pse të mbajnë më shumë se kaq lekë, nuk ka asnjë arsye financiare.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Kush është dakord me propozimin e deputetit Angjeli, që mendon se duhet hequr ky kapitull nga ligji, për ta konsideruar te ligjet e tjera të fushës?

Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni pro? Dakord? Atëherë, ky kapitull...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, drejtoreshë, çfarë problemi kishit? Sot, çfarë problemi kishit? Një milion e pesëqindmijëshin e vjetër e kontrollon dot ti? sa herë do të vejë kompania në bankë për të derdhur? Çdo ditë e çdo ditë e çdo ditë?

Delina Ibrahim – Jo. Një herë në dhjetë ditë.

Arben Ahmetaj – Po ti kërkon që në fund të ditës t'i ketë futur...

Delina Ibrahim – Jo.

Arben Ahmetaj – Si jo?

Delina Ibrahim – Limitet e përcaktuara janë për bizneset e mëdha, nëse është shqetësimi për ndërtuesit, 2 % të xhiros vjetore ...

Arben Ahmetaj – 2 % të xhiros vjetore. Në sa kohë? Në total?

Delina Ibrahim – Ai do të jetë limiti: 2 % e xhiros vjetore. Mund ta rrisim, mund ta negociojmë.

Arben Ahmetaj – Këto nuk janë probleme fiskalizimi. Duhet menduar që ky kapitull të futet te ligji i kontabilizimit.

Çfarë keni që mblidhni buzët, Niko?

Elton Haxhi – S'ka fare lidhje me kontabilitetin.

Arben Ahmetaj – Me çfarë ligji ka lidhje?

Elton Haxhi – Kontabiliteti nuk mund të vendosë kufij arke.

Arben Ahmetaj – Po si vendoske ti kufi arke?

Elton Haxhi – Sepse e kam për fiskalizimi.

Arben Ahmetaj – Por ti po flet për instrumentin, jo për procedura tatimore.

Elton Haxhi – Jo, te kontabiliteti jo njëherë.

Arben Ahmetaj – Më fal, më fal, por pse më sjell limite arke te ligji i fiskalizimit, ndërkohë që mund t'i kishe sjellë te...

Qetësi komisioni! Do t'ju lutesha për qetësi, të nderuar anëtarë!

Pse ma sillni këtu, te ligji i fiskalizimit dhe nuk ma sillni te ligji i procedurave? Cila është arsyeja?

Elton Haxhi – Te procedurat po, por jo te kontabiliteti

Arben Ahmetaj – Mirë pra, dakord!

Elton Haxhi – Thashë jo te kontabiliteti.

Arben Ahmetaj – Atëherë, radhën tjetër silleni te procedurat!

Faleminderit!

Hiqet kapitulli. Vazhdojmë me kapitullin tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Atëherë, kush është pro heqjes së këtij kapitulli? Kundër 3.

Miratohet propozimi i deputetit Angjeli, që ky kapitull të shkojë te procedurat. Përgatitini procedurat, mblidhni taksat e shtetit, jepni bonus për pensionistët, bëni infrastrukturën, na sillni ligjin e procedurave, që ta fusim motamo siç e kemi. Mbajini ligjet e pastra.

Gjëja që kam mësuar për herë të parë, kur kam vajtur në Ministrinë e Financave, është që ligjet duhen mbajtur të pastra. Procedurali mbahet procedural, logjistiku mbahet logjistik, politikat mbahen të pastra, TVSH-ja mbahet e pastër, tatim-fitimi mbahet i pastër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S'të kam dhënë leje.

Pra, silleni te procedurat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – I bashkëngjitem kërkesës që bëtë ju, por nga ana tjetër, do të kërkoja që edhe në lidhje me ligjin “Për procedurat”, që ne ndryshojmë, të jemi pak më të kujdesshëm. Nuk mund të vazhdojmë kështu, që çdo vit të ndryshojmë procedurat.

Biznesi ka nevojë për stabilitet. Ndryshimet duhet të jenë shumë të mirëmbenduara, si dhe të jenë në bashkëpunim me biznesin, për të parë që përshtatja e tyre të jetë jo çdo një vit, jo çdo dy vjet, po kur të vini me një ligj për procedurat tatimore, të parashikojë ndryshimet edhe për më tutje, pra, ndryshimet të kenë një jetëgjatësi më të madhe. Këtë do të kërkoja unë. Njëkohësisht, do të kërkoja edhe qartësi të ndryshimeve që bëjmë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A më dëgjuat?

Arben Ahmetaj – Ju dëgjova me vëmendje.

Blerina Gjylameti – Ai bashkëngjiteni kërkesës time, që ligji “Për procedurat” të jetë i mirëmbëduar...

Arben Ahmetaj – Dhe i konsultuar.

Blerina Gjylameti – I konsultuar, e thashë, por mbi të gjitha të jetë afatgjatë. Çdo dy vjet, në këtë komision kemi pasur ndryshime të ligjit “Për procedurat”. Kësisoj, do të ishte mirë të mendojmë diçka më afatgjatë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Keni shumë të drejtë! Unë jam i bindur.

Atëherë vazhdojmë.

Ju lutem, zoti zëvendësministër!

Elton Haxhi – Do të kërkoja mirëkuptimin e komisionit, që mund t’i kalojmë limitet tek procedurat, por sistemin e raportimit duhet ta mbajmë këtu, se nuk e monitorojmë dot ndryshe. Pra, detyrimin për të regjistruar limitin e arkës ta kenë, por mund të heqim limitet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Më falni, 11-ën, 39-ën i ke.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

39-ën e ke.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, Vullnet, por u votua në komision!

Elton Haxhi – Ta rishikojmë edhe një herë nenin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ndjesë, një sekondë! Çfarë shqetësimi keni, zoti zëvendësministër?

Elton Haxhi – Shqetësimi që kam është: në qoftë se e vëmë te ligji i procedurave, sistemi i raportimit nuk do të jetë i rregulluar. I bie që të kontrollohet me vizita *on spot*, pra me vizita në terren. Nëpërmjet këtij sistemi, ne mund ta monitorojmë në distancë. Në qoftë se i heqim këto dy nene...

Arben Ahmetaj – Cilët nene?

Elton Haxhi – Nenet 37 dhe 38. Duhet ta shohim një çikë me kujdes, sepse mund të na bjerë detyrimi për transmetim të dhënash.

Arben Ahmetaj – Atëherë, ju ftoj të bëni diçka që ju ndihmon edhe juve, edhe komisionin. Pra, ka rënë kapitulli X, në konceptin e limitit të arkës, ku ju përcaktoni limite. Detyrimin e raportimit shkriheni te kapitulli XI që do të jetë kapitulli X. Pra, i gjithë neni 10, që do të bëhet neni 11 i përmbledh të dyja: edhe detyrimin e raportimit dhe regjistrimin e të dhënave. Për këtë arsye, ju dhe shërbimet nuk do të largoheni nga Kuvendi pa e hartuar këtë mirë, në mënyrë që ne ta votojmë në fund në tërësi me të gjitha ndryshimet që do të paraqisni ju, të dakordësuar me shërbimet. Dakord?

Neni 39 me ndryshimet që keni përpara, që i kemi kërkuar ne. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet, por me kusht që të përfshihet definicioni dhe detyrimi për raportin të shkrihet bashkë me regjistrimin, të bashkohen me regjistrimin. Ky kapitull do të formulohet së bashku dhe do të votohet me atë logjikë.

Neni 40. Keni ndonjë gjë përtej pikave 4, 5 dhe 6 që do të ndryshojnë nga ana e teknikës legislative? Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 41 i projektligjit, sugjerohet heqja e referencave. Ka ndonjë element shtesë? Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 42 i projektligjit. E keni përpara ndryshimin: “Procedura e fiskalizimit, marrja e certifikatës elektronike, si dhe dispozitat e veçanta të procedurës së fiskalizimit për tatim paguesit që lëshojnë fatura shoqëruese bëhet në përputhje me nenet 18, 19, 20, 29, 30 dhe 31 të këtij ligji?.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te përkufizimet? Me këtë logjikë e kemi kaluar.

Nenin 1 e kemi votuar me këtë logjikë. Të reflektohet në materialin final. Në tërësi do ta votojmë me ndryshimet, siç votojmë nenet një e nga një.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 44 me sugjerimin që kam bërë për riformulim: “Ngarkohet për zbatimin dhe administrimin e këtij ligji administrata tatimore qendrore dhe AKSH-i”. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 45 riformulohet, “Sanksionet”: “Çdo veprim ose mosveprim i kryer nga tatimpaguesi që bie ndesh me dispozitat e këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet si e tillë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, për procedurat tatimore”. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka propozim?

Vullnet Sinaj – Meqenëse po kalojmë në një sistem të ri dhe do të jetë pak e vështirë për biznesin, mendoj që ky nen të mos zbatohet vitin e parë të vënies në funksion të këtij sistemi. “Ky nen nuk zbatohet për vitin e parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Arben Ahmetaj - Çfarë mendimi ka administrata?

Është pak e vështirë në fakt, bie dakord me administratën. Nuk do të tërhiqem nga riformatimi. Administrata, keni shumë të drejtë. Kush është pro me nenin 45 me ndryshimet që sugjerova? Kundër? Një kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 46. Nga Komisioni i Integritetit ka një sugjerim që përpara nenit 46 të shtohet paragrafi: “Dispozitat e këtij ligji zbatohen duke respektuar dispozitat e ligjit në fuqi “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Pikat e tjera ndryshojnë numeracionin respektivisht: 2, 3 dhe 4.

Mendoj se nuk ka nevojë, se është ligji organik. Unë jam dakord ta shtojmë. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 47 “Për shkak të hyrjes në fuqi të këtij projektligji me qëllim gradualitetin e skemës neni 47, dispozita kalimtare riformulohet. Po e lexoj:

1. “Për përdhën nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji deri më 31 mars të vitit 2020 tatimpaguesit e rinj të regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, (në fakt është QKB) dhe administratës tatimore nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe deri më 31 mars të vitit 2020 për çdo transaksion me para në dorë lëshojnë faturë ose dëftesë tatimore, si dhe dorëzojnë librin e blerjeve dhe librin e shitjeve në formën dhe procedurën e përcaktuar në këtë ligj dhe/ose legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore dhe legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar nga data 1 prill e vitit 2020 deri në fillimin e efekteve sipas nenit 49 (kemi shënuar shtatorin dhe 1 janarin) të këtij ligji këta tatimpagues mund të lëshojnë fatura në përputhje me këtë ligj ose kupon tatimor dhe/ose dokumente të tjera sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore”.

2. Për periudhën nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe deri në fillimin e efekteve sipas nenit 49 të këtij ligji të gjithë tatimpaguesit e tjerë subjekt i këtij ligji, të cilët kryejnë transaksione me para në dorë mund të lëshojnë fatura në përputhje me këtë ligj ose kupon tatimor dhe/ose dokumente të tjera sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore”.

3. Për periudhën nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në fillimin e efekteve sipas nenit 49 të këtij ligji të gjithë tatimpaguesit e tjerë, të cilët kryejnë transaksione pa para në dorë zbatojnë të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimin e vlerës së shtuar. Tatimpaguesit e administratës tatimore marrin të gjitha masat për kryerjen e testimit të sistemit elektronik lidhur me procedurat e fiskalizimit,

të lëshimit të faturave sipas parashikimeve të kreut V dhe nenit 18 të këtij ligji, që nga momenti i hyrjes në fuqi.

Pra, thelbi është që i lejon tatimpaguesit të kenë një periudhë transitore pa u penalizuar. Ky është koncepti.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Nuk ka asnjë problem, sepse maksimumi janë 4 muaj, 4 muaj ju vetë nuk jeni gati.

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi – Përderisa edhe nga kolegët këtu u ngrit shqetësimi se ky është një ligj i ri, ka shumë risi, ka shumë ndryshime dhe jo të gjithë bizneset mund t'i kuptojnë dhe t'i aplikojnë siç duhet këto që në fillim, sugjeroj që Ministria e Financave të marrë përsipër të organizojë një fushatë informimi, trajnimi në mënyrë që të gjitha bizneset ta kuptojnë dhe të informohen siç duhet. Mund të nxirrni një udhëzim, ndonjë gjë që ta shoqërojë, nuk mund të shkruhet në ligj, por është shumë e nevojshme, sepse bizneset kanë nevojë ta kuptojnë siç duhet. Pra, një fushatë 1-2 mujore.

Arben Ahmetaj - Zonja Kushi ka shumë të drejtë. Ju lutem, futeni në axhendën tuaj, konsiderojeni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në procedurë shprehesh nen për nen, por meqenëse ju doni të shpreheni në fund, unë do të kërkoja mirëkuptimin tuaj që të ishte vetëm njëri nga ju.

Neni 48. Propozoj formulimin si më poshtë: “Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës i Financave për nxjerrjen e akteve ligjore në zbatim të këtij ligji jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e tij”. Përfundimisht përcaktimit të pikës 1 të këtij neni aktet nënligjore për zbatimin e neneve 24-28 dhe neneve 39 -43 nxirren jo më vonë se data 1 qershor e vitit 2020”. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 49 “Hyrja në fuqi”. Kemi rënë dakord me riformulimin e nenit 49. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Përfundimisht pikës 1 të këtij neni në varësi të llojit të transaksionit ky ligj i fillon efektet sipas grafikut të përcaktuar në shkronjat: “a”, “b”, “c” dhe “d” të kësaj pike”.

-Për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimfitimit me të ardhura vjetore mbi 8 milionë efektet e këtij ligji fillojnë më 1 shtator të vitit 2020”.

Ligjvënësi mendon me të drejtë se tatimpaguesit dhe ju keni nevojë për më shumë kohë për informacion, për përgatitje, për aktet ligjore dhe nënligjore. 1 shtatori është në ndihmën tuaj. Pyetjes suaj: “pse jo më 1 korrik?”, unë i përgjigjem sepse ligjvënësi është i maturuar dhe ka menduar më shumë se sa administrata.

-Për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe të tatimit të thjeshtëzuar mbi fitimin dhe të ardhurat vjetore mbi 2 milionë lekë, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar të vitit 2021.

Zoti zëvendësministër po të bënit përsëri të njëjtën pyetje, përsëri të njëjtën përgjigje do të merrni.

-Për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit të thjeshtëzuar mbi fitimin me të ardhura vjetore deri në 2 milionë efektet e këtij ligji fillojnë nga 1 janari i vitit 2021.

-Për transaksionet me para në dorë ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar të vitit 2021.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra, ne i themi specifikisht një e nga një që pastaj Delina me administratën e saj të mos e shtrembërojë ligjin pa dashje, se me dashje nuk e bëjnë kurrë.

-Për transaksionet me para në dorë për tatimpaguesit dhe organeve publike efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar të vitit 2021.

-Për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve efektet e këtij ligji fillojnë më 1 korrik të vitit 2021.

Keni rënë dakord apo jo? Kemi rënë dakord për 1 janarin e vitit 2021. E keni të vështirë si datë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jua shtyjmë kohën që të përgatiteni. Kur e doni? Më sugjeroni fazat. Na ndihmoni! Ju i kishit më afër, tani thoni: “Nuk kemi kohë”. Ne po ju japim më shumë kohë, po jua shtyjmë të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sapo thatë që tatimpaguesit nuk kanë kohë. Bie në kundërshtim me logjikën. Ligjvënësi e ka menduar kështu, prandaj biem dakord me këtë logjikë.

-Për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve efektet e këtij ligji fillojnë më 1 korrik 2021. Jeni dakord?

Koment, për t'u futur në relacionin e këtij ligji. Komenti im është që Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të vijë në nëntor ose në dhjetor në varësi të kohës suaj që të relatojë për ecurinë e sistemit që nga arkitektura.

Kush është pro me nenin 49, i cili është një nen shumë i rëndësishëm, pasi ka të bëjë me gradualitetin e hyrjes në fuqi dhe dhënies kohë të bizneseve dhe të administratës për t'u përgatitur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti mendon se ne kemi hallin tuaj?

Më fal, e keni kuptuar gabim, zoti Zëvendësministër. Ne nuk kemi hallin tuaj, por të tatimpaguesve. Hallin tuaj e kemi qarë disa herë.

Momenti i fundit para se ta votojmë në tërësi: fermerët nën 5 milionë janë të përjashtuar, ka votuar ligjvënësi. Përveç atyre që përfitojnë nga skemat janë të përjashtuar edhe fermerët e tjerë.

Kam punuar vetë me ty. Një herë më thoshe: “Është e shprehur në ligj, por shiko se këtu nënkuptohet, shiko se këtu nuk është e qartë”. Jo, do të jetë e qartë.

Neni 27/1 është problem i mosqartësisë suaj, sepse nuk është shprehur në ligj. Në njërën anë të ligji “Për të ardhurat” më thoni: “Kjo nuk është e shprehur në ligj”. Unë ju them se është e shprehur në Kushtetutë që traktati është më i fortë sesa ligji në hierarki. “Shiko, po ta shprehim këtu në ligj, se ku i dihet administratës...”. Tani më thoni të kundërtën.

Votojmë në tërësi me ndryshimin për fermerët, të cilët janë të përjashtuar deri në 5 milionë.

Kush është pro në tërësi me të gjitha ndryshimet, komentet që u miratuan më parë? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Po, zoti Roshi.

Artur Roshi - Për të sqaruar votën.

Për publikun, për qytetarët dua të sqaroj pse votoj kundër, të paktën unë. Votoj kundër, sepse mendoj se 40 milionë euro që vihen në shërbim të këtij sistemi të ri që t'i përshtatemi teknologjisë, i quaj luks. Këto 40 milionë euro mund të shkonin në shërbim të katastrofës së tërmetit që ka ndodhur së fundi. Unë mendoj se sistemi që kemi funksionon. Nuk kemi pse që për luks të harxhojmë 40 milionë euro. Mund të vazhdoni 3-4 vjet më këtë sistem që kemi.

Çfarë vëmë re tjetër? Vendeve më të zhvilluara si Franca, Gjermania apo Kroacia nga është marrë ky model u janë dashur 4 vjet për ta implementuar, ndërsa ne qenkemi kaq të

zotët, që vijmë nga bota e tretë për ta implementuar brenda 6 muajve apo 1 viti?! Mendoj se plus këtyre biznesit i rritet ngarkesa.

Dje lamë disa detyra për t'i sjellë në komision, por nuk i sollën. Sa është kostoja që i rritet biznesit me teknologjinë e re, me futjen e këtij lloj fiskalizimi, sepse ende nuk ia kemi vendosur definicionin, emrin e tij?

Nga dëgjesat që kemi pasur në komision është thënë se vetëm për mirëmbajtjen biznesi duhet të paguajë 5 mijë lekë të rinj në muaj, po ngarkesat e tjera, të kompjuterëve, të programit në fillim fare, e kështu me radhë? E gjithë kjo është një barrë e shtuar për biznesin, për ta paguar biznesi. Për këto arsye jam kundër. Nuk jam thjesht kundër për arsye emocionale politike, siç mund të mendojë ndonjëri apo mund të paragjykojë dikush, prandaj dhe nuk mora pjesë në votimin nën për nën.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Roshi!

Do të takohemi në orën 16:00.

Informacionin mund të na e thoni në orën 16:00 ose tani.

Elton Haxhi - Unë e kam informacionin. Nuk është e vërtetë që nuk e kemi sjellë, jemi përgatitur, por nuk na latë kohë që ta jepnim informacionin.

Arben Ahmetaj - Në orën 16:00 do të takohemi gjithsesi.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti